



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 233, Datë 12/11/2019

PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT

Në mbështetje të nenit 143 të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë; nenit 9 të Ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit Nr.34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese; nenit 189/1/c të Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së shtetit të drejtësisë”; nenit 8 të Regullores së KLP-së “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve” Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit(mësimdhënie) pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, në lëndën “Elementë të kriminologjisë klinike dhe psikoanalitike”, për prokurorin z.Bledar Mustafaraj, në masën jo më shumë se 2(dy) orë në javë, brenda orarit të punës dhe jo më shumë se 3 (tre) orë në javë, jashtë orarit të punës, për vitin akademik 2019-2020.
2. Të njoftohet për këtë vendim z.Bledar Mustafaraj dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI

GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETARI

ALFRED BALLA

ANËTAR

ARBEN DOLLAPAJ

ANËTAR

BESNIK CANI

ANËTAR

BUJAR SHESHI

ANËTAR

ESMERALDA KESHI

ANËTAR

KOSTAQ BELURI

ANËTAR

NURIHAN SEITI



ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
VATË STAKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË VEPRIMTARISË ETIKE DHE PROFESIONALE**

RELACION

**PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT TË
MAGJISTRATIT PROKUROR Z. BLENDAR MUSTARAFAJ**

Pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është regjistruar me nr.366/3 prot., datë 17.10.2019, kërkesa për mësimdhënie e z.Bledar Mustafaraj, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Elbasan .

Z.Bledar Mustafaraj ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe njëkohësisht funksionin e Drejtuesit të Seksionit të Përkohshëm “ Për luftën kundër krimit të organizuar, trafikut të narkotikëve, korrupsionit, veprave penale në sferën ekonomike, veprave penale të kryera nga subjektet e posaçme”

Në muajin prill të vitit 2016 z.Bledar Mustafaraj ka marrë gradën “Doktor i shkencave”

Gjatë viteve të mëparshme, ai është angazhuar në veprimtari jashtë funksioni (mesimdhënie), si petagog i jashtëm për lëndët “E drejta e procedurës penale” dhe “Bazat e kriminalogjisë klinike”, në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.

Z.Bledar Mustafaraj, i kërkon Këshillit të Lartë të Prokurorisë, lejimin për të ushtruar veprimtari jashtë funksionit(mësimdhënie) për vitin akademik 2019-2020, pasi është miratuar për të dhënë mësim si petagog i jashtëm për lëndën “Elementë të kriminalogjisë klinike dhe psikoanalitike” në Universitetin Aleksandër Xhuvani”, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike”, Elbasan.

Kërkesa është bërë për të zhvilluar gjithësej 5 orë leksione në javë, prej tyre, 2 orë brenda orarit të punës dhe 3 orë jashtë orarit të punës. Gjithësej 120 orë për të dy semestrat që i takojnë vitit akademik 2019-2020.

Pagesa për këtë veprimtari do të jetë 880 lekë për çdo orë leksioni.

Sipas vërtetimit të lëshuar nga Drejtuesja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, z.Bledar Mustafaraj, deri në datën 14.10.2019, ka një ngarkesë pune prej 67 procedimesh penale në fazën e hetimit paraprak dhe 1(një) material kallëzues në fazën e verifikimit, Kjo ngarkesë është e njëjtë me ngarkesën e prokurorëve të tjerë të seksionit.

Po ashtu nga Drejtuesja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është konfirmuar se z.Bledar Mustafaraj, ka përmbushur në mënyrë korrekte detyrat e prokurorit për 12 muajt e mëparshëm si në drejtim të hetimit dhe përfaqësimit të akuzave në gjykatë ashtu

edhe përsa i përket detyrave të tjera si zv/Drejtuessit të Prokurorisë deri në muajin shkurt 2019 dhe Shefit të Seksionit.

Gjate vitit 2019, ky prokuror nuk ka përfituar ulje të ngarkesës në punë.

Nga zyra e Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme konfirmohet se z.Bledar Mustafaraj nuk është subjekt i ndonjë procedimi disiplinor dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Vlerësohet se dokumentacioni në dispozicion të komisionit për vlerësimin e kërkesës së Zj.Bledar Mustafaraj është i plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

Vlerësohet gjithashtu se ushtrimi i veprimtarisë jashtë funksionit nga z.Bldar Mustafaraj, në masën dhe kohën e kërkuar, nuk ndikon negativisht në ushtrimin e detyrës së tij si prokuror.

Sa më sipër dhe në mbështetje të nenit 143 të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë; nenit 9 të Ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit Nr.34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese ; nenit 189/1/c të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sitemit të drejtësisë”; nenit 8 të Regullores së KLP-së “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, pasi shqyrtova gjithë bazën dokumentare,

S u g j e r o j m ë

Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit(mesimdhënie) pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, për magjistratin prokuror z.Bledar Mustafaraj, në masën jo më shumë se 2(dy) orë në javë gjatë orarit të punës dhe jo më shumë se 3 (tre) orë në javë jashtë orarit të punës, në lëndën “Elementë të kriminalogjisë klinike dhe psikoanalitike” për vitin akademik 2019-2020.

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË VEPRIMTARISË ETIKE DHE PROFESIONALE

Alfded BALLA

Esmeralda KESHI

Kostaq BELURI